



Viti i XIII -te i Botimit, Nr.1,  
Qershor 2021

## MASAT E SIGURIMIT DHE DISA ASPEKTE TË ZBATIMIT NË PRAKTIKË

**Holta Seferi\***

**\*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**

**Adresë kontakti:** *holta.seferi@arsimi.gov.al*

### **Abstrakt**

Masat e sigurimit janë veprime procedurale që heqin ose kufizojnë lirinë dhe të drejtat e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal. Ato kanë si qëllim të parandalojnë veprimtarinë e mëtejshme kriminale të atij që ka kryer një vepër penale, të pengojnë shmangien e tij nga procedimi, përpjekjet që ai mund të bëjë për të vënë në rrezik marrjen e provës ose vërtetësinë e saj, si dhe të garantojnë shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale.

Liria e personit është e drejtë e mbrojtur në Kushtetutë, që mund të kufizohet vetëm me ligj, në përpjesëtim me gjendjen që ka diktuar kufizimin, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi nuk mund të cenojë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Masat e sigurimit aplikohen për shkaqe dhe kritere të përcaktuara në mënyrë të qartë në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga gjykatat e të gjitha shkallëve.

Ky punim synon të paraqesë kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit personal, duke u ndalur në trajtimin e disa rasteve nga praktika gjyqësore, lidhur me zbatimin e drejtë të dispozitave për caktimin e masave të sigurimit.

Metodologjia e përdorur në këtë punim ka të bëjë me analizën ligjore të ligjit procedural penal mbi zbatimin e masave të sigurimit, kryesisht personal, si dhe studimi dhe analiza e rasteve praktike të gjykatave tona lidhur me caktimin drejtë të masave të sigurimit personal, duke respektuar kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ligji procedural penal.

**Fjalët çelës:** *masë sigurimi, Kushtetuta, vendim, Gjykata e Lartë, procedim, vepër penale.*

Holta Seferi

## PRECAUTIONARY MEASURES AND SOME ASPECTS OF IMPLEMENTATION IN PRACTICE

### Abstract

Precautionary measures are procedural actions that deprive or restrict the freedom and rights of the person against whom criminal proceedings are conducted. They are intended to prevent further criminal activity of the perpetrator of a criminal offense, to prevent him from evading proceedings, any attempt he may make to jeopardize the taking of evidence or its veracity, and to guarantee settlement of obligations arising from the criminal offense.

The freedom of the person is a right protected in the Constitution, which can be restricted only by law, in proportion to the situation that dictated the restriction, for a public interest or for the protection of the rights of others. The restriction may not infringe the essence of the freedoms and rights and in no case may it exceed the restrictions provided for in the European Convention on Human Rights. Precautionary measures are applied for reasons and criteria clearly defined in the provisions of the Criminal Procedure Code, which are mandatory for enforcement by courts of all instances.

This paper aims to present the conditions and criteria for establishing a personal precautionary measure, focusing on the treatment of some cases from court practice, regarding the correct application of the provisions for establishing a precautionary measure. The methodology used in this paper is related to the legal analysis of the criminal procedural law on the implementation of precautionary measure, mainly personal, as well as the study and analysis of practical cases of our courts regarding the correct imposition of personal precautionary measures, respecting the conditions and the criteria provided by the criminal procedural law.

**Key words:** *precautionary measure, constitution, decision, high court, proceeding, criminal offense.*

### 1. Kuptimi i masave të sigurimit

Liria e personit është e drejtë e mbrojtur në Kushtetutë, që mund të kufizohet vetëm me ligj, në përpjesëtim me gjendjen që ka diktuar kufizimin, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve<sup>(1)</sup>. Kufizimi nuk mund të cenojë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në

---

(1) Në nenin 15, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka sanksionuar se: “*të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pa dhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik*”, neni 27, c “*askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale, ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale, ose largimin e tij pas kryerjes së saj*”.

asnjë rast nuk mund të tejkalojë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut<sup>(2)</sup>.

Në zbatim të parimeve dhe dispozitave të Kushtetutës, Kodi i Procedurës Penale, në Titullin V “Masat e sigurimit”, ka përcaktuar dhe konkretizuar mbrojtjen e të drejtave dhe rregullat për kufizimin e tyre, si dhe ka parashikuar rregulla të hollësishme për masat e sigurimit personal<sup>(3)</sup>.

Në thelbin e saj, masa e sigurimit është një kufizim i lirisë personale dhe i të drejtave pasurore pa qenë i dënuar. Vendosja e një mase sigurimi, sigurisht që është e lejuar nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kodi i Procedurës Penale e ka të specifikuar në mënyrë shumë të detajuar mënyrën e kufizimit dhe me kalimin e kohës procesi i detajimit është i pandalshëm, për shkak të rëndësisë dhe nevojës për të parashikuar në dispozita të veçanta gjithmonë e më shumë raste specifike.

Masat e sigurimit janë veprime procedurale që heqin ose kufizojnë lirinë dhe të drejtat e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal. Ato kanë si qëllim të parandalojnë veprimtarinë e mëtejshme kriminale të atij që ka kryer një vepër penale, të pengojnë shmangien e tij nga procedimi, përpjekjet që ai mund të bëjë për të vënë në rrezik marrjen e provës ose vërtetësinë e saj, si dhe të garantojnë shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale.

Një masë sigurimi është një kufi shumë i hollë midis lirisë së personit nga njëra anë dhe të drejtës së shtetit për siguri publike nga ana tjetër. Në bazë të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Por ato nuk mund të përdoren për arritjen e qëllimeve kriminale ose në dëm të interesave të të tjerëve, prandaj mund të kufizohen me ligj.

Interpretimet në lidhje me masat e sigurimit mbi të gjitha duhet të jenë të bazuar mbi konceptet e të drejtës kushtetuese dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Interpretimet e tjera duhet të jenë vetëm në ndihmë të interpretimit të parë. Njohuritë e thella në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë një bazë e rëndësishme për të kuptuar masat e sigurimit dhe për të shpjeguar përshtatjen e tyre rast pas rasti me liritë dhe të drejtat e individit.

Vlen të theksojmë se masat e sigurimit nuk janë dënime penale që të përdoren si masë ndëshe kimore për personin që dyshohet se ka kryer një vepër penale dhe, nga ana tjetër, nuk jepet për të lehtësuar punën e organit të prokurorisë në hetimin e një çështje penale. Masat e sigurimit

---

(2) Neni 17, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

(3) Nenet 228 e 229 parashikojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit.

janë masa që lidhen me nevojat e sigurimit dhe jepen mbi disa kushte dhe kritere të përcaktuara qartësisht. Nga kjo, sjellim në vëmendje se, edhe nëse gjykata, gjatë caktimit të masës së sigurimit, do të shohë se ndaj të dyshuarit ka prova të mjaftueshme për fajësinë e tij, seanca e masës së sigurimit duhet të ketë në fokus vetëm nëse ndaj të dyshuarit duhet të caktohet masë sigurimi dhe se cila masë sigurimi është më e përshtatshme.

Masat e sigurimit aplikohen për shkaqe dhe kritere të përcaktuara në mënyrë të qartë në nenet 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar qartësisht rastet e heqjes dhe kufizimit të lirisë së personit:

- Kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
- Për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për mos zbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;
- Kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryera jen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;
- Për mbikëqyrjen e të miturit për qëllim edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;
- Kur personi është përhapës i një sëmundje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;
- Për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimitit<sup>(4)</sup>.

Të gjitha këto raste të heqjes së lirisë, në kuptimin e gjerë, janë masa sigurimi që synojnë parandalimin dhe luftën efektive kundër kriminalitetit dhe rreziqeve të tjera që i kanosen shoqërisë.

Kodi i Procedurës Penale ka zbërthyer dhe konkretizuar rastin kur personit mund t'i hiqet liria "kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj".

Ky është rasti që lidhet drejtpërdrejt me procedimin penal dhe që ndeshet më shpesh në praktikën e subjekteve të këtij procedimi, si një masë sigurimi që sjell heqjen e lirisë dhe shërben për zhvillimin me sukses të luftës kundër kriminalitetit dhe sidomos kundër krimeve të rënda.

Masat e sigurimit ndahen në masa të sigurimit personal dhe masa të sigurimit pasuror. Ndryshimi thelbësor midis tyre qëndron në faktin se masat e sigurimit personal vendosen ndaj personit, ndërsa masat e sigurimit pasuror vendosen ndaj pasurisë së personit. Të dyja këto lloj

---

(4) Neni 27 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar të gjitha rastet e kufizimit të lirisë së personit.

masash mund të vendosen ndaj personit fizik. Kushtet dhe kriteret për të vendosur një masë sigurimi personal ndryshojnë nga kushtet dhe rrethanat kur mund të vendoset një masë sigurimi pasuror.

Masat e sigurimit personal drejtohen ndaj personit të dyshuar për kryerjen e një veprë penale, duke e privuar nga disa të drejta ose duke e ngarkuar me detyrime të veçanta.

Në këtë kuptim, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, masat e sigurimit personal ndahen në masa shtrënguese dhe masa ndaluese.

#### **2. Kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal. Raste të zbatimit në praktikë.**

Për vendosjen e një mase sigurimi personal, siç janë:

- ndalimi i daljes jashtë shtetit;
- detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore;
- ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar;
- garancia pasurore;
- arresti në shtëpi;
- arresti në burg;
- shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik;
- pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik;
- ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste,

duhet të ekzistojnë disa kushte të rëndësishme, mosplotësimi i të cilave në mënyrë automatike do të sillte moslejimin e saj ose rënien e masës së sigurimit. Këto kushte kanë të bëjnë vetëm me masat e sigurimit personal dhe jo ato pasuror.

Kushtet<sup>(5)</sup> për caktimin e masave të sigurimit personal parashikohen nga Kodi i Procedurës Penale dhe ato janë:

- 1) Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se nuk ekziston në ngarkim të tij një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova.
- 2) Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së veprës penale.
- 3) Masat e sigurimit personal vendosen:
  - a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës;

---

(5) Neni 228 i Kodit të Procedurës Penale parashikon kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal.

- b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;
- c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilën procedohet.

### **Rast praktik nr. 1.**

Lidhur më parashikimin e dispozitës për kushtet e caktimit të masave të sigurimit dhe problemet e zbatimit të saj në praktikën gjyqësore, më poshtë do të parashtrijmë një rast praktik të Kodit Penal të Gjykatës së Lartë, e cila me vendimin nr. 99, datë 26.07.2005, ka konstatuar se:

“.....Që ndaj një personi të caktohet masë sigurimi personal kërkohet që gjykata të bindet se në ngarkim të tij ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova që ka kryer një veprë penale dhe mbi bazën e rrezikshmërisë së veçantë të kësaj veprë dhe të vetë personit, brenda kriterëve që përcakton neni 228 i K.Pr.Penale të caktojë ndaj tij masën më të përshtatshme.

Në kundërshtim me këtë detyrim ligjor, Gjykata e Apelit Tiranë, në caktimin e masës së sigurimit personal për të pandehurin I. B. ka gjykuar çështjen në themel edhe duke ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës për të cilën akuzohet ky i pandehur. Është qëndrim jo i mbështetur në ligj arsytimi i Gjykatës së Apelit Tiranë se “... nga aktet e ndodhura në dosje rezulton tërësisht e provuar se i pandehuri I. B. nuk ka kryer veprën penale të vrasjes të mbetur në tentativë...”. Në këtë fazë të gjykimit të çështjes, detyrim i gjykatës nuk është analiza e provave rreth fajësisë së të pandehurit, por të provojë që dyshimet e arsyeshme të jenë të bazuara në prova. Në dosjen hetimore dhe gjyqësore janë të administruara prova të tilla siç është edhe vetë kallzimi i A. A. që tregojnë se i pandehuri, në ngjarjen e datës 02.05.2005, me një pistoletë që mbante pa leje ka qëlluar në drejtim të pronarit të lokalit duke bërë kështu që në ngarkim të këtij të pandehuri të jenë dyshime plotësisht të arsyeshme dhe të bazuara që ai të ketë tentuar të vrasë këtë person dhe që ka mbajtur e përdorur armë pa leje. Të bësh analizën e anës subjektive të veprës penale, jo vetëm vjen ndesh me kërkesat e ligjit procedural penal por edhe me praktikën shumë vjeçare në këtë fushë.....<sup>(6)</sup>”.

Pasi janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurimit personal, atëherë analizohen kritieret për caktimin e masës së sigurimit personal.

Kështu, në caktimin e masave të sigurimit, gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Në këtë rast mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara në Kodin Penal.

---

(6) Vendimi nr. 99, datë 26.07.2005 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

### MASAT E SIGURIMIT DHE DISA ASPEKTE TË ZBATIMIT NË PRAKTIK

Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.<sup>(7)</sup>

#### **Rast praktik nr. 2.**

Në rastin që do të parashtrijmë më poshtë, gjykata ka argumentuar se personi i dyshuar nuk ka rrezikshmëri shoqërore dhe se në caktimin e masës së sigurimit nuk mund të përdoret si argument përhapja e gjerë e veprës penale në shoqëri apo nevoja e vendosjes së masës me qëllim parandalimin e fenomeneve të caktuara shoqërisht të rrezikshme.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 258, datë 29.10.2008, ka konstatuar se:

“.....Nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë, në caktimin e masës së sigurimit për të pandehurin Y. S., nuk janë zbatuar drejt dispozitat e nenit 229 dhe 230 të K.Pr.Penale. Kjo gjykatë nuk ka mbajtur parasysh përshtatshmërinë e masës së caktuar me nevojat e sigurimit dhe as rëndësinë e faktit me sanksionin që parashikon dispozita e nenit 245/1-II të K.Penal. Në vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, në kundërshtim me sa parashikon dispozita e nenit 230 të K.Pr. Penale, nuk është arritur të arsyetohet se përse asnjë masë tjetër sigurimi personal siç ishte dhe ajo e caktuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë Berat ka qenë e pa përshtatshme për t’iu caktuar të pandehurit Y. S.

Nuk rezulton që i pandehuri Y. S. të paraqesë rrezikshmëri të veçantë shoqërore dhe arsyetimi i gjykatës së apelit lidhur me rrezikshmërinë e veçantë të veprës, për faktin se ajo godet dhe parandalon format e reja të shfaqjes së korrupsionit, është i lidhur jo me caktimin e masës së sigurimit personal, por mund të mbahet parasysh nga gjykatat në masën e dënimit nëse i pandehuri do të deklarohet fajtor.

Masat e sigurimit personal nuk kanë lidhje me parandalimin e veprave penale, por jepen nga gjykata me qëllim për të lehtësuar organet e prokurorisë gjatë fazës së hetimit paraprak dhe për të mos vënë në rrezik marrjen e provës gjatë kësaj faze, apo për të evituar rrezikun e ikjes së të pandehurit apo rrezikun që prej tij të kryhet një vepër tjetër penale<sup>(8)</sup>”.

Përveç kriterëve të përgjithshme që duhet të mbahen parasysh në caktimin e masës së sigurimit, gjykata duhet të marrë në konsideratë edhe kriteret e veçanta që parashikohen nga Kodi i Procedurës Penale.

Lidhur specifikisht me masën e sigurimit të “arrestit me burg”, Kodi i Procedurës Penale parashikon disa kriteret të veçanta për caktimin e kësaj mase, të cilat janë si më poshtë:

---

(7) Neni 229 i Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal.

(8) Vendim nr. 258, datë 29.10.2008 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Holta Seferi

- Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit.
- Nuk mund të vendoset arresti në burg ndaj një gruaje që është shtatzënë ose me fëmijë në gji, ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë ose që ka kaluar moshën shtatëdhjetë vjeç ose një personi toksikoman apo të alkoolizuar, për të cilin zbatohet një program terapeutik në një institucion të posaçëm.
- Në rastet e parashikuara në pikën 2 arresti në burg mund të vendoset vetëm kur ka shkaqe të një rëndësie të veçantë për krimet që dënohen jo më pak në maksimum se dhjetë vjet burgim.
- Të miturit nuk mund të arrestohen kur akuzohen për kundërvajtje penale<sup>(9)</sup>.

### Rast praktik nr. 3.

Më poshtë do të paraqesim një rast nga praktika gjyqësore, lidhur me zbatimin e kritereve për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

Kështu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 119, datë 30.05.2008, ka konstatuar se:

“.....vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës, lidhur me llojin e masës së sigurimit personal të caktuar shtetases V. Xh. nuk është i bazuar në ligj, pasi në kundërshtim me sa kërkohet nga dispozita e nenit 230/1, gjykatat nuk kanë arsyetuar se cilat janë shkaqet që asnjë masë tjetër sigurimi personal nuk ka qenë e përshtatshme për t’iu caktuar të pandehurës, veç asaj të “arrestit në burg”. Dispozita e nenit 230/1 të K.Pr.Penale, si kriter të veçantë për caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, ka përcaktuar rrezikshmërinë e veçantë të veprës dhe të pandehurit.

*Ndërkohë që me të drejtë gjykatat kanë çmuar se vepra paraqet rrezikshmëri të veçantë shoqërore për shkak të përhapjes dhe të pasojave që ajo sjell, lidhur me rrezikshmërinë e të pandehurës, në vendimet e gjykatave jo vetëm nuk është mundur të arsyetohet se kjo rrezikshmëri është e veçantë në atë shkallë që ndaj saj duhet të caktohet vetëm masa e sigurimit personal “arrest në burg”, por rezulton se e pandehura është nënë e katër fëmijëve, e pa dënuar më parë dhe nuk ka asnjë rrethanë që ta konsiderojë atë me rrezikshmëri të veçantë, siç kërkon dispozita e nenit 230/1 të K.Pr.Penal*

*e<sup>(10)</sup>*”. Nëse bëjmë një vështrim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, mund të themi se si rregull, masat e sigurimit caktohen në mungesë. Kështu, neni 244 i K.Pr.Penale parashikon se, masat e sigurimit caktohen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet në të cilat bazohet kërkesa për caktimin e masës së sigurimit. Në këtë rast gjykata merr vendimin e arsyetuar në dhomë këshillimi<sup>11</sup>.

(9) Neni 230 i Kodit të Procedurës Penale.

(10) Vendimi nr. 119, datë 30.05.2008 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

(11) Citojmë dispozitën e nenit 244 (Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit) të K.Pr. Penale, ku përcaktohet se: “1. Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa. Vendimi merret në dhomë këshillimi dhe jepet i arsyetuar”.

### MASAT E SIGURIMIT DHE DISA ASPEKTE TË ZBATIMIT NË PRAKTIK

Kujtojmë se kjo dispozitë ka pësuar ndryshime në përmbajtje, nëpërmjet ndryshimeve të bëra dispozitave të Kodit të Procedurës Penale ndër vite. Kështu, parashikimi i bërë për marrjen e vendimit të arsyetuar nga gjykata në dhomë këshillimi, është shtuar me ligjin nr. 35, datë 30.03.2017.

Po kështu, një dispozitë e rëndësishme dhe thelbësore është ajo e parashikuar në paragrafin e tretë të këtij neni, shtuar me ligjin nr. 8813, datë 13.06.2002, nëpërmjet të cilit përcaktohet se gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori. Pra, në këtë mënyrë, ligjvënësi i ka dhënë të gjitha atributet dhe kompetencat organit të akuzës për vlerësimin e kushteve për caktimin e masës së sigurimit ndaj personit nën hetim.

Për sa parashtruar më lart, si përfundim mund të themi se masat e sigurimit janë pjesa më e rëndësishme dhe më e diskutuar në praktikën penale. Dispozitat penale që lidhen me masat e sigurimit kanë patur trajtime dhe interpretime nga më të ndryshmet. Kuptimi sa më qartë dhe i saktë i tyre është me interes, për shkak se këto dispozita janë të lidhura drejtpërdrejtë me liritë personale dhe pasurore të individit.

Holta Seferi

### Referencat

1. Në nenin 15, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka sanksionuar se: *“të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pa dhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”*, neni 27, c *“askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale, ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale, ose largimin e tij pas kryerjes së saj”*.
2. Neni 17, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
3. Nenet 228 e 229 parashikojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit.
4. Neni 27 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar të gjitha rastet e kufizimit të lirisë së personit.
5. Neni 228 i Kodit të Procedurës Penale parashikon kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal.
6. Vendimi nr. 99, datë 26.07.2005 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
7. Neni 229 i Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal.
8. Vendim nr. 258, datë 29.10.2008 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
9. Neni 230 i Kodit të Procedurës Penale.
10. Vendimi nr. 119, datë 30.05.2008 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
11. Citojmë dispozitën e nenit 244 (Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit) të K.Pr.Penale, ku përcaktohet se: *“1. Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsytet ku bazohet kërkesa. Vendimi merret në dhomë këshillimi dhe jepet i arsyetuar”*.